



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 870/3 prot.

Shkodër, më 04.02.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.94, datë 23.12.2024.

KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54/k, neni 55/3, neni 64 germa c, Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Ligjit Nr.57/2020 “Për pyjet”, VKM Nr.433 date.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, ligjit Nr.111/2024 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.9693 datë.19.03.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë.9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, pas depozitimit të dokumentacionit Nr.76/2prot datë 28.01.2025 lidhur me **VKB Vau-Dejës Nr.94 datë 23.12.2024: “Mbi miratimin paraprak të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore “Karmë” dhe “Shosh 2” në Administrim të Bashkisë Vau-Dejës”, Ju autorizon të procedoni.**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





Nr. 46 P
At: 09.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 870/1prot.

Shkodër, më 06-01-2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.94, datë 23.12.2024.

KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54/k, neni 55/3, neni 64 germa c, Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet", VKM Nr.433 date.8.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive" të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, ligjit Nr.111/2024 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.9693 datë.19.03.2007 "Për fondin kullor" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1 datë.9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", dokumentacionit të depozituar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.7622prot, datë.27.12.2024, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës Nr.94 datë 23.12.2024**: "Mbi miratimin paraprak të planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Karmë" dhe "Shosh 2" në Administrim të Bashkisë Vau-Dejës".

Pas analizimit të dokumentacionit në tërësi:

- Në zbatim të Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 4, pika 1, germa b,ii, sipas kërkesave të nenit 11 pika 3, germa a, neni 17 pika 1, germa "P" të Ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet", (si dhe në zbatim të detyrave të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit), ky vendim duhet të garantojë gjithëpërfshirjen e popullsisë lokale, element që mungon te VKB.
- Vendimi nuk ka bashkëlidhur planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore "Karmë" dhe "Shosh 2", në administrim të Bashkisë Vau-Dejës".
Për sa trajtuar, Prefekti nuk ju autorizon të procedoni.
Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 94 datë 23.12 2024

“Për miratimin paraprak të planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 në administrim të Bashkisë Vau Dejës”.

Mbështetur Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 datë 03.04.2020 neni 11 shkronja b dhe c“Për pyjet”, manualit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janar 2019 miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nr 864 prot datë 30.01.2019 neni 2, VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar“Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, *Këshilli Bashkiak Vau Dejës*:

V E N D O S I

1. *Miratimin paraprak* të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2.
2. Afati i vlefshmerise së planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 do të jetë 10 (dhjetë) vjet .
3. Vlera e hartimit të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 sipas kontrates së shërbimit me Bashkinë Vau Dejes nr 3637/8 prot me datë 15.07.2024 është 8 521 902 me T V SH .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

KRYETAR
Ervis Shimaj



Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN CELEPIJA

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 27.12 2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Spektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 27, datë 16.12.2024

Për miratimin paraprak të planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 në administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Mbështetur Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” në zbatim të parashikimeve të ligjit nr 57/2020 datë 03.04.2020 neni 11 shkronja b dhe c “Për pyjet”, manualit të planeve të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave janar 2019 miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nr 864 prot datë 30.01.2019 neni 2, VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, **i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës ____ . ____ 2024 të :

V E N D O S I

1. **Miratimin paraprak** të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2.
2. Afati i vlefshmerise së planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 do të jetë 10 (dhjetë) vjet .
3. Vlera e hartimit të planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2 sipas kontrates së shërbimit me Bashkinë Vau Dejës nr 3637/8 prot me datë 15.07.2024 është 8 521 902 me T V SH .

HARTOI PROJEKT-VENDIMIN

DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Konceptoi: Mark Suli, Specialist

Pranoi: Zeqir Ujka, Përgjegjes

Miratoi: Vehbi Shkëjau, Drejtor

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
ALEKSANDRA GJONI**



Spektori Ligjor Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritit:

Konfirmoi bazën ligjore të projektvendimit- Ersilda Preka, Specialist

Pranoi bazën ligjore të projektvendimit Marinela Deda, Drejtor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 60 prot.

Vau Dejës, më 16.12. 2024

RELACION

PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MBARËSHTIMIT TË EKONOMIVE PYJORE KARMË DHE SHOSH 2 NË ADMINISTRIM TË BASHKISË VAU DEJËS

Në zbatim të ligjin nr 57/2020 datë 03.04.2020, neni 11 pika 2 shkronja b dhe c "Për pyjet" bazuar në kontratën nr **3637/8 prot datë 15.07.2024** "për hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2", shresen nr 40 prot date 13/12/2024 per perfundimin e e raportit perfundimtar të planeve të mbarështimit të ekonomise pyjore Karmë dhe Shosh 2 dhe administruar me nr. pro.3637/16, datë 13.12.2024 pranë Bashkisë Vau Dejës ,akt marrjes në dorzim nr 3637/17prot 13/12/2024 datë me poshtë po relatojmë në lidhje miratimim përfundimtarë të planeve të mbarështimit të ekonomise pyjore Karmë dhe Shosh 2,

Bashkia **Vau i Dejës**, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31,118 ha Pyje dhe Kullota.

Pjesë e këtij administrimi janë edhe ekonomia pyjore **Karmë dhe Shosh 2**, për të cilat janë realizuar planet e **mbarështimit të Pyjeve dhe kullotave**.

Hartimi i planeve të mbarështimit të ekonomisë pyjore **Karmë dhe Shosh 2** synon mbulimin e aspekteve ekonomike, sociale dhe ekologjike, njohja e burimeve lokale, duke përfshi produktet drusorë dhe jo drusore, kullotat gjendjen e turizmit, njohja e problemeve si erozioni, rrëshqitjet, zjarret në pyje , prerjet ilegale mbikullotja etj.

Të dhënat e planeve te mbareshtimit te ekonomive pyjore jepen si **me poshte**:


	Ekonomia pyjore Karme, Perdorimi	Siperfaqja ne ha	Ekonomia pyjore Shosh 2 Perdorimi	Siperfaqja ne ha
1	Pyll	1343.82	Pyll	1736.3
2	Kullotë	138.81	Kullotë	29.8
3	S.Bimesi Pyjore	134.28	S.Bimesi Pyjore	235.6
4	Sipërfaqe	99.74	Sipërfaqe	2

	inproduktive		inproduktive	
5	Bujqesore ,Troje	48.9	Bujqesore ,Troje	53.1
11	Totali	1765.55		2056.8

Të dhëna për Ekonominë Pyjore Karmë

Ekonomia pyjore **Karmë** ka një sipërfaqe prej **1765.55 ha**. Kjo e dhënë ka rezultuar nga matjet e reja të kryera për hartimin e këtij Plani mbarështrimi. Tabela me përdorimin sipërfaqet dhe përqindjet jepet më poshtë. Nga të dhënat shohim që pjesën më të madhe e zënë sipërfaqet me pyje të cilat kapin **76%**. Më pas vijnë kullotat të cilat kapin **8%**, sipërfaqet me bimesi pyjore **7%**, inproduktive **6%** shëe Bujqesore **3%**.

Përdorimi	Sip ha	Përqindja
Pyll	1343.82	76.2%
Kullotë	138.81	7.8%
S.Bimesi Pyjore	134.28	7.6%
Sipërfaqe inproduktive	99.74	5.6%
Bujqesore ,Troje	48.9	2.8%
Total	1765.55	100%



Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues

Masat silvikulturore të tilla si rrallimet, krasitjet, ripërtëritja, punimet përmirësuese në fazat e reja do të synojnë në prodhimin e biomasës dhe materialit drusor për dru zjarri dhe lëndë ndërtimi për qëllime familjare për popullsinë lokale dhe kur kushtet ta lejojnë, për tregtim. Aplikimi i tyre do të sigurojë gjithashtu aktivitete dhe përfitime për komunitetet. Funkzioni prodhues gjithashtu do të harmonizojë dëshirat e banorëve për të optimizuar prodhimet direkte dhe indirekte nga pyjet dhe kullotat si: Parqe eolike, parqe fotovoltaike, agroturizmin, agro-pylltarinë, bimët mjekësore, kullotat etj.

Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni(Social)

Peizazhet dhe ekosistemet e saj spektakolare ka një potencial për të ofruar aktivitete rekreative dhe turistike dhe për të zhvilluar ekoturizmin midis banorëve. Kjo do të sigurojë të ardhura shtesë për ekonominë pyjore dhe në të njëjtën kohë përfaqëson një burim punësimi për popullsinë lokale. Po ashtu edhe aktivitetet ekonomike mund të krijojnë të ardhura të qëndrueshme sidomos në zonat ku sipas përdorimit të territorit nuk ka mundësi për aktivitetë të tjera.

Në varësi të kërkesës do të jenë edhe të ardhurat, ajo që është e evidente është që aktiviteti për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplohëse, kulturore etj, si edhe aktiviteti për parqe eolike dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), janë ato me fitimprurëse dhe që ka kërkesa nga komuniteti.

Ekonomia Pyjore Shosh 2


Ekonomia pyjore “**Shosh 2**” është formuar në basenin ujëmbledhës të liqenit të Komanit dhe përmbledh pjesën veriore të Bashkisë Vau Dejës. Ekonomia ka kufij të qartë natyralë.

- **Veri**, Kufizohet nga kufiri ndarës me Njësine Administrative Shosh, rrethi Shkodër
- **Jugë** : Nga kufiri ndarës me Bashkinë Vau Dejës e Rrethit të Pukës
- **Lindje**: Me rrethin e Pukës (dhe liqenin e Komanit)
- **Perëndim**: Kufizohet me njësine administrative Shllak.

Në inventarizimin e vitit 1978 ka qënë e emërtuar “Ekonomia Pyjore Malagji Kajvall me dy pjesë ekonomike shosh 2 -1 dhe shosh 2-2, me ndarje në lumin e shalës në një sipërfaqe prej **4651.77 ha**. Nga kjo sipërfaqe sipas ndarjes territoriale të vitit 2014, si dhe VKM në 433/2016, ndryshuar me VKM 684/2020, datë 02.09.2020, në bashki kemi të transferuar **2210.4 ha**, ndërsa Bashkia Shkodër **2241.4 ha**. **Plani i ri i Mbarëshimit të Pyjeve e e kullotave sipas përdorimit të territorit paraqitet si më poshtë:**

Nr.	Ekonomia pyjore Shosh 2, Perdorimi	Siperfaqja në ha	Përqindja
1	Pyll	1736.3	84.4
2	Kullotë	29.8	1.5
3	S.Bimesi Pyjore	235.6	11.5
4	Sipërfaqe inproduktive	2	0.1
5	Bujqesore ,Troje	53.1	2.5
	Total	2056.8	100%

Shperndarja e siperfaqes se ekonomise pyjore shosh 2 ne %



Objektivat kryesore te PMP Shosh 2

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunktional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore **Shosh 2** duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë optimizimin e përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme, qëllimet kryesore janë: - Arritja e qëndrueshmërisë dhe shumë funksionalitetit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e lëndës drusore të prodhuar, të mirëmbahet mbrojtja ndaj erozionit dhe rreziqeve natyrore, të ruhet biodiversiteti, të sigurohen të ardhura dhe burime sipas nevojave

lokale, të mbahet ekosistemi vital dhe në gjendje të mirë shëndetësore. - Përmirësimi i rritjes natyrore të grumbujve pyjorë përmes ndërhyrjeve silvikulturore, duke synuar njëkohësisht balancim më të mirë midis klasave të moshës dhe rritje të kapitalit drusor dhe sekuestrimit të karbonit. Lejimi i ripërtëritjes së pyjeve me praktika të përshtatura të kullotjes. Rimëkëmbja e mbulesës së degraduar të vegjetacionit nëpërmjet pyllëzimeve.

- Mundësimi i ndërtimit të rrjetit rrugor në fshatrat njësisë administrative Temal, për mundësimin e lëvizjes së tyre deri në pikat e lidhjes me mjetet lundruese në liqenin e Komanit dhe me pas hapja e rrugëve auto-pyjore për shfrytëzimin e materialit drusor për pyjet e pa mbërritëshme dhe që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë. Në këtë njësi administrative, ku përfshihet edhe ekonomia pyjore Shosh 2 nuk ka rrugë lidhëse në fshatra. E vetmja rrugë auto është rruga Vau Dejes- Koman, që lidhë vetëm qendrën e Njësisë Administrative Temal. Lëvizja e banorëve të zonës Temal bëhet vetëm me mjete lundruese nëpërmjet liqenit të komanit.
- Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve për ndërhyrje të përshtatshme në pyje në përputhje me nevojat e tyre, si dhe objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve e Kullotave.
- Zbatimi i masave aktuale nëpërmjet veprimeve interaktive dhe të bashkërenduara që lidhen me palët e interesuara lokale dhe zhvillojnë ndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kontrollit ndaj mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme etj.

Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni(Social)

- Peizazhet dhe ekosistemet e Zonës janë spektakolare. Kanë një potencial për të ofruar aktivitete rekreative dhe turistike dhe për të zhvilluar ekoturizmin midis banorëve. Kjo do të siguronte të ardhura shtesë për ekonominë pyjore dhe në të njëjtën kohë përfaqëson një burim punësimi për popullsinë lokale. Po ashtu edhe aktivitetet ekonomike mund të krijojnë të ardhura të qëndrueshme sidomos në zonat ku sipas përdorimit të territorit nuk ka mundësi për aktivitete të tjera.
- Si aktivitete kryesore dhe që kanë edhe impakt social -ekonomik si për Bashkinë Vau Dejes, ashtu edhe për komitetin e zonës janë ushtrimi i aktiviteteve të agroturizmit, shfrytëzimi i rezurseve që ofron zona për veprimtari turistike, shllodhese, kulturore, sporte ujore etj.
- Gjithashtu zona është shumë e pasur me bimë medicinale për grumbullimin e tyre, duke siguruar të ardhura ekonomike për komunitetin, si dhe një llojshmëri të madhe të bimëve e drurëve mjaltëse, duke krijuar një premise të madhe për mbarështimin e Bletarisë.
- Krahas kësaj është një zonë shumë e mirë për mbarështimin e blegtarisë, pasi zona fillon nga 180 m deri në 1500 m mbi nivelin e detit.

Nga ana e subjektit, sipas konstatimeve tona, janë bërë rregullimet përkatëse për përdorimin e territorit sipas funksioneve përkatëse, bazuar në Manualin e mbarështimit të Pyjeve, miratuar me shkresë nr 864, date 30.01.2019.

Bazuar në sa më sipër, kërkohet nga ana jauj miratimi paraprak i planeve të mbarështimit për ekonomitë pyjore Karmë dhe Shosh 2.

Mbetemi në pritje të miratimit paraprak të planit të mbarështimit të ekonomive pyjore Karmë dhe Shosh 2, Bashkia Vau Dejës.


Ju faleminderit

DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

**Specialist
Ing. Mark Suli**



**Drejtori
Vehbi Shkjau**



**Përgjegjës
Ing. Zeqir Ujka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 3637/prot.
17.

Vau Dejës, më 13 / 12. / 2024

AKT ÇERTIFIKIMI

Për Marrjen në dorëzim të projektit “Hartimi i planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore “Karme, Shosh 2-1, Shosh 2-2”

Raporti perfundimtare

I mbajtur sot më datë 13 / 12 / 2024 nga grupi i punës i ngritur me urdhërin e titullarit të autoritetit kontraktor, Bashkia Vau Dejës nr. 501 prot, datë 15 / 07 / 2024, i përbërë nga Vehbi Shkaj, Mark Suli dhe Nikolin Kaçi, për monitorimin e kontrates nr 3637/8 datë 15/07/2024 për hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore “Karme, Shosh 2-1, Shosh 2-2”.

Objektivi i përgjithshëm i planit të mbarështimit do të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Vau Dejës (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Grupi i punës realizoi kontrollin e punimeve në terren dhe dokumentave të realizuara nga subjekti “Lurimi” shpk si me poshtë:

1. Ekonomia pyjore “Karme” u kontrolluan 32 sipërfaqe prove të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë ekonominë dhe u konstatu se kunjat prej metali ishin vendosur brenda kritereve teknikë sipas rrjetit kilometrik sipërfaqet prove ishin marre sipas kritereve teknikë të percaktuara në udhëzuesin për hartimin e planeve të mbarështimit bashkëlidhur foto të pikave të kontrolluara.

Objekt kontrolli ishin keto pika:

559,576,569,593,574,597,611,612,616,663,664,665,642,643,655,656,666,675,714,772,730,739,747,748,764,772,781,786,787,788,802,740.

Bashkëlidhur foto të pikave të kontrolluara.

Ndarja parcelare është kryer në rregull me shenja të dukshme me boje vaji duke marre parasysh edhe sugjerimet e bera nga drejtoria e pyjeve, hartat ishin konform udhëzuesit për hartimin e planeve të mbareshtimit.

Ndarja e parcelave/nënparcelave si njësi orientuese, organizative për planifikim dhe kontroll.

Nr.	Treguesit: Përcaktimi i parcelave/nënparcelave në hartë dhe terren	Gjendja Aktuale	Ç'duhet bërë
1.	Kufij të qartë natyror për parcelat e ekonomive.	Ne rregull	
2.	Shënimi i parcelave në terren i njëjtë me hartën	Ne rregull	
3.	Shenjat në terren të qëndrueshme (shkëmb, shtylla, drurë, boja e mirë)	Ne rregull	
4.	Është referuar ndarja e vjetër parcelare	Ne rregull	
5.	Nënparcelat janë njësi homogjene	Ne rregull	
6.	Parcelat/nënparcelat janë hedhur si duhet në hartë	Ne rregull	
7.	Detajimet e hartës janë të plota (rrugë, shtëpi, etj)	Ne rregull	

➤ **Përshkrimi i plotë dhe i saktë i nënparcelës si bazë e rëndësishme e PMPK**

Nr.	Treguesit: Të dhënat në skedën e terrenit	Gjendja Aktuale	Ç'duhet bërë
1.	Shkrim i mirë dhe i lexueshëm	Ne rregull	
2.	Të gjitha kriteret janë vlerësuar	Ne rregull	
3.	Vlerësimi i kriterëve është i saktë	Ne rregull	
4.	Gjendja aktuale	Ne rregull	

Ekonomia Pyjore "Shosh 2:1 dhe Shosh 2:2" u kontrolluan 13 sipërfaqe prove të shpërndara në menyre të barabartë në të gjithë ekonominë dhe u konstatu se kunjat prej metali ishin vendosur brenda kriterëve teknikë sipas rrjetit kilometrik sipërfaqet prove ishin marre sipas kriterëve teknikë të percaktuara në udhëzuesin për hartimin e planeve të mbareshtimit bashkëlidhur foto të pikave të kontrolluara.

Objekt kontrolli ishin keto pika:

317,316,186,487,488,489,491,504,284,214,184,185,490.

Bashkëlidhur foto te pikave te kontrolluara.

Ndarja parcelare është kryer në rregull me shenja të dukshme me boje vaji duke marre parasysh edhe sugjerimet e bera nga drejtoria e pyjeve, hartat ishin konform udhëzuesit për hartimin e planeve të mbarështimit.

Ndarja e parcelave/nënparcelave si njësi orientuese, organizative për planifikim dhe kontroll.

Nr.	Treguesit: Përcaktimi i parcelave/nënparcelave në hartë dhe terren	Gjendja Aktuale	Ç'duhet bërë
1.	Kufij të qartë natyror për parcelat e ekonomive.	Ne rregull	
2.	Shënimi i parcelave në terren i njëjtë me hartën	Ne rregull	
3.	Shenjat në terren të qëndrueshme (shkëmb, shtylla, drurë, boja e mirë)	Ne rregull	
4.	Është referuar ndarja e vjetër parcelare	Ne rregull	
5.	Nënparcelat janë njësi homogjene	Ne rregull	
6.	Parcelat/nënparcelat janë hedhur si duhet në hartë	Ne rregull	
7.	Detajimet e hartës janë të plota (rrugë, shtëpi, etj)	Ne rregull	

➤ **Përshkrimi i plotë dhe i saktë i nënparcelës si bazë e rëndësishme e PMPK**

Nr.	Treguesit: Të dhënat në skedën e terrenit	Gjendja Aktuale	Ç'duhet bërë
1.	Shkrim i mirë dhe i lexueshëm	Ne rregull	
2.	Të gjitha kriteret janë vlerësuar	Ne rregull	
3.	Vlerësimi i kriterëve është i saktë	Ne rregull	
4.	Gjendja aktuale	Ne rregull	




Mbështetur në rezultatet e supervizimit në terren dhe dokumentacionit ky subjekt ka realizuar punimet perfundimtare ne afatet kohore, sipas kontrate të specifikuar në grafikun e zbatimit të aktiviteteve të miratuara më parë dhe sa më sipër vendosi të çertifikojë punën e kryer nga subjekti "Lurimi" shpk, për fazën e dytë (Punimet e terrenit) që përbëjnë 47 % të vlerës së preventivit 4 005 294 (Kater million zero zero pese mije dyqind e nentdhjete e kater) lekë me TVSH, sipas situacionit të derguar nga subjekti të percaktuara ne kontrate që ky subjekt ka fituar tenderin dhe ka lidhur kontratën për kryerjen e shërbimit të konsulencës, për hartimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore "karme " dhe "shosh 2:1 dhe Shosh 2:2", Bashkia Vau Dejës, duke krijuar mundësinë për likuidimin financiar, sipas situacionit dhe faturës tatimore të fiskalizuar bashkangjitur këtij akti çertifikimi.

Ky akt çertifikimi u mbajt në tre kopje të barabarta, dy prej të cilave i mban Bashkia Vau Dejës dhe e treta i jepet subjektit kontraktues "Lurimi" shpk.

PËR BASHKINE VAU DËJËS

KOMISIONI

1. Vehbi Shkijou Antare. 2. Mark Sule Antare. 3. Nikolin Haxhi Antare.






Lurimi Shpk

Adresa: Lagjia "Drita", ish reparti ushtarak Burrel.
Telefon : +35521722703 Mob;0683044904
Adresa e Email : info@lurimi.com

Prot 40 nr.



Burrel me: 13/12/2024

Lenda: Situacion nr.2 per 47% te punimeve per "Punimet e planit te mbareshtimit ek.pyjore KARME, SHOSH 2.1 DHE SHOSH 2.2"

Drejtuar: BASHKIA VAU DEJES

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës

Ne zbatim te kontrates nr.3637/8 dt.15.07.2024 per hartimin e planit te mbareshtimit per pyjet e kullotat bashkiake ekonomite pyjore *Karme, Shosh 2.1 Dhe Shosh 2.2* me dorezimin e draftit perfundimtare, bashkelidhur ju dergojme situacionin e punimeve sipas nenit 8 "Kushtet e pageses" te kontrates.

Duke ju falenderuar

ADMINISTRATOR

Inxh. Lutfi Miftari



Adresa: Lagjia, "Drita", Burrel, e-mail: info@lurimi.com